

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS – MALLRA

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje kancelari”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT: (F.P.P.)

30191000-4 - Pajisje zyre përveç mobiljeve

VLERA E FONDIT LIMIT TË KONTRATËS: 1 621 623.4 *(një milion e gjashtëqind e njëzet e një mijë e gjashtëqind e njëzet e tre pikë katër) lekë pa TVSH:*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti kontraktor ALBCONTROL ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të V.K.M.-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, citohet: “Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Në Nenin 82, të LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 25 të V.K.M.-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet**. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: "Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata". Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme."

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës "Procedurë e hapur të thjeshtuar" edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2 (c) e V.K.M. Nr 285 dt 19.05.2021 "Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

2.3.2 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit të objektit që prokurohet. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
 - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 55, pika 4 gërma (b) të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4 gërma (b) të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar duke qënë se vlera e fondit limit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

- 2.3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatën **ISO 9001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë”** / ose ekuivalent (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 79 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën gjejmë të përcaktuara se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Ky kriter gjen mbështetje në piken 1 të nenit 44 të V.K.M. nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se

punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organisma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Sa më sipër, ky kriter shërben për njohjen e kapacitetit të operatorëve ekonomikë ofertues dhe aftësinë e tyre teknike dhe profesionale për të furnizuar artikuj cilësorë dhe që janë prodhuar / vendosur në treg sipas standardit të sipërpërmendur. ISO 9001 përcakton kërkesat për një sistem menaxherial të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. (e nevojshme për objektin e prokurimit, të cilin AK kërkon të kryhet me cilësi dhe në kohë). Duke parë objektin e prokurimit, autoriteti kontraktor vlerëson të nevojshme të kërkojë që operatorët ekonomikë ofertues të jenë të pajisur me çertifikata të cilësisë në përputhje me objektin e prokurimit, me qëllim që furnizimet të kryhen me cilësi sipas çertifikatës ISO të mësipërme.

ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” – Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse mallrat e ofruara janë të cilësisë së duhur. Çertifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të mallit në adresën përkatëse të autoritetit kontraktor, sipas përcaktimeve në këto dokumente tenderi.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendin e caktuar nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.4 Për artikujt e mëposhtëm (sipas renditjes në Shtojcën nr. 6 “Formulari i specifikimeve teknike”) operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog / skedë teknike të prodhuesit, ku të evidentohet artikulli i ofruar dhe specifikimet korresponduese, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së tyre me dokumentet e tenderit.

Nr. Rendor sipas Shtojcës 6	Emërtimi	Njësia
45	Letër fotokopje, 80gr/m2 A3	Risma
46	Letër fotokopje A4 200gr/m2	Risma

47	Letër A4 200 gr/m2	Risma
48	Letër fotokopje 80gr/m2 ngjyra blu e hapur	Risma
49	Letër fotokopje color me ngjyra të ndezura,	Risma
50	Letër fotokopje 80gr/m2 ngjyra e verdhë	Risma
51	Letër fotokopje 80gr/m2, ngjyra jeshile	Risma
52	Letër fotokopje 80gr/m2, me 5 ngjyra të ndryshme në një rismë, me ngjyra të lehta.	Risma
53	Letër për printim certifikatash trajnimi	Risma
54	Letër traktor A4	Risma
88	Toner për Konica Minolta Bizhub C368	copë
89	Toner për Konica Minolta Bizhub C308	copë
90	Toner për Konica Minolta Bizhub C360i	copë
91	Toner për Konica Minolta Bizhub C3110	copë
92	Toner për Xerox Versalink C7120	copë
93	Toner për HP Laser Pro 300 Mfp	copë

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenit 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 6/b, të nenit 40, të V.K.M. Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesa për paraqitjen e katalogëve / ose skedës teknike është një kërkesë e domosdoshme pasi i jep mundësinë Autoritetit Kontraktor verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar nga operatorët ekonomikë me specifikimet teknike të hartuara nga Autoriteti Kontraktor për nevojat e tij. Autoriteti Kontraktor ka përzgjedhur artikujt për të cilët kërkon paraqitjen e katalogut / skedës teknike, duke patur parasysh kompleksitetin e specifikimeve teknike, çka sjell si pasojë nevojën për verifikim përmes dokumenteve teknike, si më sipër.

A.K. ka kërkuar katalogët e mallit që do të ofrohet nga O.E. për të vërtetuar se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesa për katalogët e produktit ka rëndësi specifike për këtë procedurë prokurimi, pasi katalogu i produktit lehtëson punën e A.K. për të verifikuar nëse produkti i ofruar nga O.E. plotëson standartet e përcaktuara nga AK në përputhje me përcaktimet e specifikimeve teknike të publikuara në D.T.

Operatori ofertues duhet të paraqesë katalog **(të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar në rast se katalogu nuk është në gjuhën e kerkuar në dokumenta tenderi)** për çdo produkt, ku në katalogët përkatës të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike, ku të gjejnë pasqyrim për parametrat teknikë të produktit **(të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuar, përveç elementëve teknik specifik, termave në anglisht që përdoren ndërkombëtarisht, që janë vendosur në specifikimet teknike (shih specifikimet teknike)).**

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostrat të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike në D.T., për artikujt e listuar në Shtojcën nr. 6 si më poshtë:

Nr. Rendor sipas Shtojcës 6	Emërtimi	Njësia	Sasia e mostrës
43	Letër fotokopje, 80g/m2 A4	Risma	1

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Autoriteti kontraktor ka gjykuar të arsyeshme paraqitjen e mostrave për disa artikuj, duke marrë në konsideratë sasinë e tyre, si dhe frekuencën e shpesh të përdorimit të tyre nga autoritetet kontraktore me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të artikujve të ofertuar me ato të përcaktuara në D.T. Ky kriter i siguron autoritetit kontraktor se mallrat e ofruar janë të cilësisë së kërkuar. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

I. Argumentimi i Specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktimi i specifikimeve teknike, pjesë e D.T. ngarkuar ne S.P.E. e A.P.P., për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të L.P.P. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët anëtarë të njësisë së prokurimit, bazuar në nevojat e autoritetit kontraktor.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

Njësia e Prokurimit